



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon ekspertë të jashtëm të kualifikuar në fushën e transmetimeve audiovizive për hartimin e Dokumentacioneve teknike për koordinimi e brezit të frekuencave III VHF për transmetimet T-DAB/DTT.

TERMAT E REFERENCËS

Objektivi

Dhënia e asistencës së nevojshme teknike Autoritetit të Mediave Audiovizive, për 1 vit (2023-2024), duke sugjeruar parametra teknik të koordinimit të brezit III VHF me administratat e vendeve kufitare sipas standardeve ndërkombëtare;

Detyrat:

Eksperti, nëpërmjet dokumentit që do të dorëzojë duhet të:

1. Të analizojë dokumentacionin e prodhuar nga AMA apo administratat e vendeve fqinje për koordinim frekuencor në brezin III VHF për transmetimet T-DAB/DTT;
2. Të sugjerojë parametra teknik për koordinimin frekuencor në brezin III VHF për transmetimet T-DAB/DTT për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
3. Të marrë parasysh që koordinimi të përfshijë nevojën për sigurimin e përdorimit sa më të frytshëm, të dobishëm dhe përfitues të burimeve të AMA-s;
4. Të përfshijë një studim të frytshmerisë dhe dobishmerisë të dokumentit gjatë kohës së zbatimit të saj;
5. Dokumenti final duhet të jetë i shoqëruar me një plan veprimi;
6. Të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin e Mediave Audiovizive gjatë hartimit të dokumentit;
7. Nëpërmjet dokumentit teknik të AMA-s duhet të bëhen të qarta strategjia dhe objektivat e koordinimit.

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

1. Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në inxhinieri elektronike/telekomunikacioni;
2. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë në fushën e transmetimeve në radiofrekuencë;
3. Të njohë kuadrin rregullator i cili rregullon tregun audioviziv si dhe të njohë zhvillimet e fundit në këtë fushë;
4. Të njohë procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive;
5. Të ketë eksperiencë të mëparshme në hartimin e studimeve për transmetimet audiovizive;

Përbën avantazh:

- Kandidatët me përvojë pune mbi 5 vite në mësimdhënie në nivelet Bachelor ose Master në fushat e Inxhinierisë së Telekomunikacionit;
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime mbi aspekte të zhvillimit të transmetimeve audiovizive në Shqipëri (të paraqiten referencat përkatëse);

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Diploma e shkollës së lartë;
2. Dokumentacioni që vërteton punë të ngjashme;
3. Fotokopje e librezës së punës që vërteton vitet e eksperiencës/vërtetim nga punëdhënësi;
4. Jetëshkrimi;
5. Kopje ID/Pasaportë;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- | | |
|---|---------|
| 1. Diploma e shkollës së lartë; | 40 pikë |
| 2. Vitet e eksperiencës; | 20 pikë |
| 3. Dokumentacioni për punë të ngjashme; | 20 pikë |
| 4. Jetëshkrimi; | 20 pikë |

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 8 Shtator 2023, ora 12:00, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, 1010, Tiranë